



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 38, Datë 06/02/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 9, datë 16.01.2018, e Znj. P. T., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “moshës”, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Korçë, Zyrës së Punës Korçë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se P. T., e datëlindjes 01.09.1963, është banuese në qytetin e Korçës, e divorcuar dhe prej 7 vitesh e papunë. Ajo është diplomuar Bachelor në Hortikulturë, pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në vitin 2014, si dhe ka përfunduar Master Profesional “Për Zhvillim të Integruar Rural”, pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në vitin 2016. Ankuesja ka kryer edhe kurse profesionale për bebisiter, guzhiniere, kompjuter dhe anglisht të ofruara nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik, Korçë. Ankuesja pretendon se ka takuar Kryetarin e Bashkisë Korçë, të cilit i ka kërkuar punësim, por ky i fundit e ka drejtuar pranë